



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK
SEKRETARIATI

RAPORT VENDIMMARRJEJE

Komisioni i shërbimit, shëndetit publik dhe pronave

Datë 26.1.2026

Lenda: "PËR MIRATIMIN E SHITJES SË PASURISË ME NR. 302/2 VOLUM 3 FAQE 206 E LLOJIT "PA FRUT" ME SIPËRFAQE 4196.26 M² PASURI E REGJISTRUARA NË ASHK DREJTORIA VENDORE KAVAJË NË PRONËSI TË BASHKISË KAVAJË, NDODHUR NË ZONËN KADASTRALE 2291 KRYEMËDHENJ, NJËSIA ADMINISTRATIVE GOLEM, NË FAVOR TË SUBJEKTIT EVEREST KURTI".

Analiza ligjore:

Në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9 pika 1, nënpika 1.1, shkronja (b), nënpika 1.2 shkronja "a", "c" nenit 18 pika 2, nenit 54 shkronja "e", nenit 55 pika 4, të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, nenit 4 të Ligjit 8743 datë 22.02.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit" i ndryshuar, ligjit 111/2018 "Për kadastrën", ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore" të ndryshuar, të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, të Vendimit nr. 15 datë 08.11.2024 të Këshillit Kombëtar të Territorit "Për miratimin e Lejes së Ndërtimit për objektin "NAUTILIUS" Strukturë Hotelerie 13 Kate dhe 2 Kate nëntokë, me vendodhje në Golem, Bashkia Kavajë" si dhe të kërkesës së subjektit Everest Kurti me nr. 5403 prot. Datë 10.11.2025 për blerje të pasurisë.

Situata aktuale e funksionit:

Sipas relacionit përmbledhës të përgatitur nga Drejtoria e Kadastrës Urbane, Menaxhimit të Aseteve Publike, kryetari i Bashkisë, i paraqet Këshillit Bashkiak dhe i propozon të vendosë:

1. Miratimin e shitjes së pasurisë Nr.302/2, lloji pasurisë Pa Frut, me sipërfaqe të përgjithshme 4196.26 m², pasuri e regjistruar në pronësi të Bashkisë Kavajë, në Drejtorinë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Kavajë në Vol 3 faqe 206, ZK 2291 Kryemëdhenj, Njësia Administrative Golem.
2. Çmimi i shitjes do të përcaktohet sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.
3. Për zbatimin e këtij vendimi dhe ndjekjen e procedurave të mëtejshme, ngarkohet Kabineti i Kryetarit të Bashkisë, Drejtoria Ligjore, Drejtoria e Kadastrës Urbane Menaxhimit të Aseteve Publike dhe Drejtoria e Burimeve Ekonomike.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut, Tiranë.

5. Pas miratimit të këtij vendimi, të njoftohet Ministria përgjegjëse për Ekonominë mbi shitjen e pasurisë shtetërore objekti i këtij vendimi, për qëllime informacioni dhe bashkërendimi institucional, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Drejtoria/Spektori përgjegjes:

Drejtoria e Kadastrës Urbane Menaxhimit të Aseteve Publike

Monitorimi dhe raportimi:

Drejtoria e Kadastrës Urbane Menaxhimit të Aseteve Publike dhe Drejtoria e Burimeve Ekonomike.

Impakti social/grupet që preken:

Banorët bashkisë Kavajë.

A është objekt konsultimi:

PO- Konsultimi është zhvilluar konform legjislacionit në fuqi dhe rregullores së Këshillit Bashkiak.

Komisioni i përhershëm i Financave, Taksave, Revizionimit u mbledhë më datë 26.1.2026 dhe shqyrtoi projekt-vendimin e mësipërm, relacionin dhe dokumentat shoqerues të tij.

Pas shqyrtimit të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese, Komisioni me shumicë votash, vendosi:

T'i propozojë Këshillit bashkiak:

- a- Kalimin e projektaktit në mbledhjen e Këshillit për vlerësimin e mëtejshëm dhe për shqyrtim
- b- Miratimin e projekt aktit
- c- Refuzimin e miratimit të projektaktit
- d- Miratimin e projektaktit me ndryshimet si vijon:

Anëtarët e Komisionit

Denisa Qehajaj

Kryetar

Orges Sinella

Nen/Kryetar

Shqipe Baulja

Anetar

Ahmet Habili

Anetar

Alburena Hylviu

Anetar